



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA / OPŠTINA / MUNICIPAL
SHTIME / ŠTIMLJE



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Uprava za Zdravstvo i Socialnu Zaštitu - Department of Health and Social Welfare

Nr. 07/3

Datë: 20.02.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d), Nenin 17 pika (k), dhe Nenin 24, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/32 të datës 27.01.2023, për ndarjen 100€ për Nënat-Lehona për ç'do fëmijë të lindur në vitin 2023, si dhe për fëmijët e lindur në vitin 2022, që nuk kanë pas mundësi me aplikuar në vitin 2022, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, bënë këtë:

NJOFTIM

NJOFTOJMË të gjitha Nënat – Lehona, të Komunës së Shtimes, që kanë lindur fëmijë nga data 01.01.2023, si dhe për fëmijët e lindur në vitin 2022 që nuk kanë pas mundësi me aplikuar në vitin 2022, se mund të aplikojnë për përfitimin e kompensimit në shumën prej 100€ (njëqind euro) për ç'do fëmijë të lindur gjatë vitit 2022/2023, sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/32 të datës 27.01.2023.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

1. Letër njoftimi i Nënës,
2. Çertifikata e Vendbanimit të Nënës,
3. Ekstrakti i Lindjes së Fëmijut,
4. Llogaria Bankare në emër të Nënës.

Aplikimi mund të bëhet çdo ditë pune nga ora 9.00-16.00 në Zyrën Pritëse (kati përdhësë) ndërtesa e Komunës – Shtime.

Për informata shtesë mund të drejtoheni te zyra e drejtorisë së shëndetësisë, kati i III.



Drejtori i DSHMS-së
Dr. Isa Haxhiu